



Pranuar / Doretuar Priljevoj / Prilato Received / Delivered	21. 12. 2020	viti god year	
Organ / Kështja Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHK	3249/2020		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.344/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.344/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga "Nexhat Hetemi", Nr. 54, në fshatin Lumadh në Komunën e Vushtrrisë, kundër Vendimit me Nr. 14-070/01-0189053/20 të datës 28.10.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.344/2020 e datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 14-070/01-0189053/20 i datës 28.10.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.
- III. MBETET në fuqi Njoftimi i datës 13.10.2020 i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës lidhur me rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Çështje Pronësore".

**A r s y e t i m**

Komuna e Prishtinës, në bazë të autorizimit të datës 26.06.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 02.07.2019 ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Çështje Pronësore", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa pas përfundimit të procesit të rekrutimit ankuesi më datë 15.10.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve

dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës më datë 28.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-070/01-0189053/20 me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës së ankuesi, duke dhënë udhëzimin juridik: *Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes pasi në afat prej 30 ditësh në Gjykatën Themelore në Prishtinë.*

Ankuesi, kundër këtij vendimi, më datë 05.11.2020 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:2451/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Kjo e fundit më datë 18.11.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2451/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën e ankuesit me Nr. 2379 e datës 02.09.2020; Diplomën e ankuesit me Nr. 5691 e datës 13.09.2018; Njoftimin e datës 13.10.2020 nga Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës; Ankesën e datës 15.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr. 14-070/01-0189053/20 të datës 28.10.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Kërkesën e datës 14.10.2020 për qasje në dokumentet publike e ankuesit; Kontratë punë për Kohë të caktuar nga VIVA FRESH STORE; Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga ana e të punësuarit; Marrëveshje për punë shtesë dhe pushim vjetor e datës 03.10.2020, 28.10.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 10.02.2020; Kontratë SHPRK e datës 13.02.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtri e datës 07.07.2020; Fletëpranim i datës 30.10.2020; Konkursin e datës 02.07.2020 të shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën "Zyrtar për Çështje Pronësore"; Autorizimin për publikimin e konkursit i datës 26.06.2020; Vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil i datës 27.07.2020; Formulari për pranimin e aplikacioneve; Formulari i listës së ngushtë; Lista e datës 17.08.2020 për kandidatët që do të nënshtrohen testit me shkrim; Njoftimi i datës 28.08.2020 për intervistë me gojë; Formularin Form.MAP-SHCK-08 për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për ankuesin; Formularin Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 04.08.2020; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 09.07.2020 me provat e bashkangjitura; Testin me shkrim të datës 20.08.2020 të ankuesit dhe kandidatës [REDAKTUAR]; Kërkesën për punësim e datës 13.07.2020 nga kandidatja [REDAKTUAR] me provat e bashkangjitura; Raporti Final i rekomandimi nga komisioni rekrutues i datës 07.10.2020; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Njoftimi i datës 17.08.2020 për testim me shkrim; Kërkesë/Lutje e datës 04.12.2020 e dërguar nga [REDAKTUAR] për Kryetarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDACTED] [REDACTED] është e pabazuar, sepse:

Me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, mirëpo Avokati i Popullit ka parashtruar ankesë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji. Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes se masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020 ka lëshuar njoftim me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Komunë e Prishtinës, më datë 26.06.2020 ka marr aprovimin nga Ministria e Administratës Publike në bazë të cilit, më datë 02.07.2020 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Çështje Pronësore" në kuadër të Drejtorisë së Pronës, ku kriteret e konkursit kanë qenë: *"Diplomë universitare, drejtimi Juridik pa përvojë ose shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune"*. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në listën e shkurtër, ka marr pjesë në testin me shkrim dhe me gojë, mirëpo në bazë të njoftimit të datës 13.10.2020 nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në ankesën e datës 05.11.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë: se është zbatuar në mënyrë të gabuar Ligji për Shërbimin Civil dhe Rregullorja Nr.02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse janë shfuqizuar nga Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili në nenin 83 paragrafi 9 ka përcaktuar mënyrë e përfundimit të konkursit të shpallur; Procedura nuk është zhvilluar në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës pasi kanë qenë në fuqi; Vlerësimi i testit me shkrim është bërë në kundërshtim me legjislacionin; Kishte edhe kurdisje të përqindjes së pikëve përfundimtare pasi që kisha përgatitjen me të mirë, përvojën e punës dhe pikë më së shumti; Në njoftimin e datës 13.10.2020 në udhëzim juridik kandidatëve të pakënaqur me rezultatin kanë të drejtë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ndërsa pas ankesës sime ky komision është shpall jo kompetent;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin se është zbatuar në mënyrë të gabuar Ligji për Shërbimin Civil dhe Rregullorja Nr.02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse janë shfuqizuar nga Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili në nenin 83 paragrafin 9 ka përcaktuar mënyrë e përfundimit të konkursit të shpallur, ka konstatuar që dispozitat tranzitore të nenit 8 paragrafit 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcakton që: *"Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.."*, çka nënkupton se procedurat e konkursit të nisura para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë do të vazhdojnë me legjislacionin që është filluar procedura e konkursit edhe nëse Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë fillon së zbatuari, me këtë rast konkursin për pozitën "Zyrtar për Çështje Pronësore" është shpallur nga Komuna e Prishtinës më datë 02.07.2020 para së të nis së zbatuari Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mbi këtë bazë

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Komuna e Prishtinës konkursin e ka shpallur në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar sepse dispozitat ligjore që janë aplikuar me rastin e zhvillimit të procedurës kanë vlejti deri në përfundim të kësaj procedure.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin se procedura nuk është zhvilluar në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës pasi kanë qenë në fuqi, ka konstatuar se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk i ka obliguar institucionet që konkurset në proces t'i vazhdojnë me këtë ligj, kështu që edhe pse kanë qenë në fuqi dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ato do të aplikohen vetëm për shpalljen e procedurave të rekrutimit mbi bazë të këtyre dispozitave, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin se vlerësimi i testit me shkrim është bërë në kundërshtim me legjislacionin dhe kishte edhe kurdisje të përqindjes së pikëve përfundimtare pasi që kisha përgatitjen me të mirë, përvojën e punës dhe pikë më së shumti, ka konstatuar që në bazë të shqyrtimit të dosjes së procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Çështje Pronësore", vlerësimi si i testimit me shkrim dhe me gojë është bërë në pajtim me nenin 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse tani për tani nuk janë duke u aplikuar procedurat e vlerësimit sipas Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sepse nuk kanë filluar ende procedurat e rekrutimit sipas kësaj rregulloreje. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kriteret e konkursit për pozitën e lartcekur kanë qenë: *"Diplomë universitare, drejtimi Juridik pa përvojë ose shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune"*, në kuptim të këtyre për këtë pozitë për kandidatët të cilët kanë diplomë universitare nga drejtimi Juridik nuk kërkohet përvojë punë ndërsa përvojë pune dy (2) vjet kërkohet vetëm për kandidatët të cilët kanë të përfunduar shkollën e lartë. Në bazë të dosjes së ankuesit konstatohet se i njëjti posedon Diplomën e datës 13 shtator 2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Juridik, po ashtu kandidatja e rekomanduar për këtë pozitë [REDACTED] [REDACTED] posedon Diplomë e datës 10 korrik 2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Juridik, mbi këtë bazë të dy kandidatët i kanë plotësuar kushtet e konkursit për nga përgatitja profesionale, rrjedhimisht Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka zbatuar drejtë nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtar e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional"*. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që në bazë të Formularit të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë janë vlerësuar me 63 pikë ndërsa ankuesi është renditur i dyti me 62.5% të pikëve, andaj në shërbimin emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin

3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paañësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin se në njoftimin e datës 13.10.2020 në udhëzim juridik kandidatëve të pakënaqur me rezultatin kanë të drejtë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ndërsa pas ankesës sime ky komision është shpall jo kompetent, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës është dashur që të vendos meritortsht për ankesën e ankuesit, sepse edhe udhëzimi juridik në njoftimin e datës 13.10.2020 ka qenë që palët e pakënaqura i drejtohen këtij komisioni. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse më lartë ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Çështje Pronësore”, është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi të aplikueshëm për kohën e zhvillimit, atëherë ka vendosur që Vendimi me Nr. 14-070/01-0189053/20 i datës 28.10.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës të shfuqizohet.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr.344/2020; datë 21.12.2020

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së